

VENDIM
Nr.262, datë 23.4.2004

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË QENDRËS KOMBËTARE
PRITËSE TË AZILKËRKUESVE NË BABRRU, TIRANË, MINISTRISË SË RENDIT
PUBLIK, SI DHE PËR ORGANIZIMIN E FUNKSIONIMIN E SAJ, DHE PËR NJË SHITESË
NË NUMRIN E PARASHIKUAR TË PUNONJËSVE TË KËSAJ MINISTRIE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8492, datë 27.5.1999 “Për të huajt”, të ndryshuar, të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të shkronjës “e” të nenit 3 të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit” dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Qendra Kombëtare Pritëse e Azilkërkuesve në Babrru, Tiranë të kalojë në varësi dhe përgjegjësi administrimi nga Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit, Ministrisë së Rendit Publik dhe të shërbejë për të pritur e për të sistemuar azilantët në Republikën e Shqipërisë.

2. Qendra Kombëtare Pritëse e Azilkërkuesve është person juridik publik buxhetor, me zë të veçantë në buxhetin e Ministrisë së Rendit Publik.

3. Struktura dhe organika e Qendrës Kombëtare Pritëse të Azilkërkuesve miratohet nga Ministri i Rendit Publik dhe për funksionimin e saj për vitin 2004, numrit të parashikuar të punonjësve të Ministrisë së Rendit Publik t’i shtohen edhe 15 veta.

4. Emërimi dhe shkarkimi i punonjësve të Qendrës Kombëtare Pritëse të Azilkërkuesve bëhen me urdhër të Ministrit të Rendit Publik.

5. Ruajtja dhe sigurimi i kësaj qendre kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

6. Efektet financiare për pagat, sigurimet dhe shpenzimet operative të përballohen nga buxheti i vitit 2004, miratuar për Ministrinë e Rendit Publik.

7. Ngarkohen Ministri i Rendit Publik, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano